

VALBONA SINANAJ

THEKSI LOGJIK DHE EMOCIONAL NË TRAGJEDINË “SKËNDERBEU” TË ETËHEM HAXHIADEMIT

Lufta për gjuhën e shkruar shqipe që shqiptarët kanë zhvilluar në shekuj, përfaqëson përpjekjet e tyre për të ruajtur e afirmuar identitetin kombëtar, dëshirën e tyre për të folur dhe shkruar shqip. Rilindja Kombëtare njihet edhe si periudha që ka prekur jetën shpirtërore dhe mendore të realitetit shqiptar. Në fushën e krijimtarisë artistike paraqiten gati të gjitha format dhe gjinitë letrare. *Letërsia shqipe e gjysmës së parë të shek. XIX kishte shumë vepra me trajtë e brendi që mund të krahasoheshin me vepra rrymash, krejt të ndryshme madje të largëta*¹. Kështu ndodhi dhe me dramaturgjinë, e cila fizionominë standarde e mori në saje të përhapjes së botës mitike parahistorike dhe historike. Shkrimtarët më të njohur që u morën me dramën gjatë shek. XX ishin A. Çajupi, F. Noli, Gj. Fishta, K. Floqi dhe E. Haxhiademi. Në veprat e tyre u pasqyruan jo vetëm veçori të botës shpirtërore të popullit shqiptar, por edhe fakte të rëndësishme të historisë së tij.

Gjuhësia e ka zbuluar parimin e individualitetit të pamohueshëm të faktit estetik, atëherë kur ka pranuar se fjala në realitet është të folurit dhe, se nuk ka fjalë krejtësisht të njëjta. Të folurit është krijim i vazhdueshëm, ajo që shprehet një herë me anë të fjalës nuk përsëritet veçse me riprodhimin e asaj që ka qenë prodhuar më parë. Përshtypje gjithnjë të reja i lënë shteg

¹ A. Xhiku, *Letërsia shqipe si polifoni*, Tiranë, 2004, f. 277.

ndryshimit të vazhdueshëm të zërave e domethënieve ose shprehjeve gjithnjë të reja².

Nëpërmjet zhvillimit të aftësive pragmatike folësit janë në gjendje të bëjnë zgjedhjet e tyre gjuhësore në përputhje me rrethanat, duke njohur qëllimin e bisedës për krijimin e identiteteve dhe të marrëdhënieve shoqërore. Gjuha na ndihmon ta modelojmë botën tonë pikërisht nëpërmjet komunikimit³.

Fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX është periudha ku zënë fill disa disiplina gjuhësore, një ndër të cilat është edhe semiotika. Në qoftë se Sosyri e përkufizoi semiologjinë si *shkenca që studion jetën e shenjave në gjirin e shoqërisë*, Mukazhorvski letërsinë dhe poezinë i konsideron *fakte semiotike*⁴, ai e nënkupton veprën artistike si në lloj të veçantë të shenjave, të cilat mund të kuptohen vetë brenda teorisë së përgjithshme të shenjave. Në faktorët semiologjikë përfshihet intonacioni, pauza, theksi, të cilët në përputhje me synimet e folësit luajnë rol në kuptimin e njësive gjuhësore.

Sipas Dreslerit, “teksti shihet si një njësi gjuhësore e formuar sipas rregullave gramatikore të një gjuhe, që folësi dhe dëgjuesi e konceptojnë gjuhësisht të përfunduar”. Teksti qëndron në themel të çdo organizimi të komunikimit gjuhësor. Komunikimi ynë nuk bëhet me fjalë të vetmuara a me fraza të shkëputura, ai rrjedh në tekste⁵.

Sipas Bartit, “teksti është një hapësirë, një shfaqje fenomenale e veprës letrare, është thurima, endja e fjalëve të përdorura në vepër, të përzgjedhura dhe të rregulluara në mënyrë të tillë, që të përftojnë një kuptim të qëndrueshëm e unik, sa më

² B. Kroçe, *Estetika si shkencë e shprehjes dhe e gjuhësisë së përgjithshme*, Tiranë, 1998, f. 193, 194.

³ V. Sinanaj, *Ndikimi ndërgjuhësor në kontaktin midis dy gjuhëve. Rasti i shqipës me italishten*, ASA, IGJL, Tiranë, 2020, f. 26.

⁴ A. Jefferson, D. Robey, *Teoria letrare modern. Një paraqitje krahasuese*, Tiranë, 2004. f. 80.

⁵ Sh. Rrokaj, *Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*, Tiranë, 2012, f. 172.

shumë që të jetë e mundur. Një përjasje me natyrën e pjeshme dhe modeste të nocionit (ai nuk është veçse një objekt i perceptueshëm në kuptimin pamor vizual), teksti merr pjesë në lavdinë shpirtërore të veprës, për të cilën ai është shërbyes i rëndomtë, i zakonshëm, por i nevojshëm”⁶.

Shek. XX e zgjeroi hapësirën e interpretimit, duke përfshirë në të edhe tekstin, po ashtu edhe lexuesin. Shek. XXI ka nisur me mëtimin e rinovimit të koncepteve për vetë procesin e përfutimit të vlerave në bashkëmarrëdhëniet mes autorit, tekstit dhe lexuesit, duke i përcaktuar ato bashkëmarrëdhënie si proces komunikues, dhe vlerat e përfutura në atë proces si të kushtëzuara nga ligjësitë e diskursit letrar⁷.

Koncepti i paratopisë, lindi përgjatë një mënyre tjetër të konceptimit të diskursit letrar, ndërsa tejkalohen kufijtë ngushtues të estetikës romantike, ndërsa procesi krijues parakuptohet si marrëdhënie më e ndërlikuar, jo thjesht e raportit krijues-shoqëri, por edhe si marrëdhënie me fushën letrare në të cilën integrohet natyrshëm krijuesi, ndërsa vepra letrare konsiderohet si akt komunikues në të cilin krijuesi është në kërkim të *një vendi e një jo-vendi*, ndërsa *e thëna* dhe *të thënë*t përvijohen në një territor të midisshëm, ashtu si vetë letërsia që përfutet midis kufijsh dhe jo në një territor të caktuar; ndërsa *përfshirja / jo-përfshirja* në fushën letrare do të ndryshojë karakteristikat në kohë dhe hapësirë⁸.

E. Haxhiademi mund të vështrohet si një rast domethënës, vepra e të cilit bart pikërisht këtë ekzistencë mes kufijsh në të cilën përfutet vepra e tij letrare, me tensionet e natyrshme që do të nxiste vetë vepra edhe në përbërje të fushës letrare të viteve

⁶ Cituar sipas T. Plangaricës në *Tekst, për tekstin*, Elbasan, 2002, f. 17.

⁷ T. Plangarica, *Variant leximi i poezisë “Kristal” të I. Kadaresë*, botuar në përmbledhjen me studime *Kadare, leximi dhe interpretimi*, Onufri, 2016, f. 3.

⁸ T. Plangarica, *vep. cit.*, f. 170.

'30, me parapëlqimet dhe kundërshtimet që lindin edhe brenda kësaj fushe⁹.

E. Haxhiademi lindi në Elbasan më 8 mars 1902. Studimet e mesme i përfundoi në Leçe të Italisë e Insbruk të Austrisë (1919-1923), ndërsa studimet e larta për shkencat politike-juridike në Berlin e Vjenë (1924-1928). Vitet e fundit të jetës së tij i mbylli në burgjet e diktaturës, ku vdiq më 1965. Haxhiademi është krijues i tragjedisë shqiptare. Ai krijoi shtatë tragjedi, “Pirroja”, “Aleksandri”, “Skënderbeu”, “Akili”, “Diomedi”, “Ulisi” dhe “Abelik”, subjektet e të cilave i mori nga mesjeta shqiptare, nga mitologjia antike dhe biblike. Personazhet e tragjedisë së tij janë heronjtë e mitologjisë greke dhe mbretër që mbartin interesa të fateve të vendit që ata drejtojnë.

Duke imituar tragjedinë klasikiste, Haxhiademi përpiqet të pasqyrojë në veprat e tij, jo vetëm ndjenjën e lakmisë për pushtet, por edhe ndjenjën e dashurisë, fisnikërisë dhe dhemshurisë prindërore, gjithnjë nën sundimin e arsyes¹⁰.

Në tragjedinë “Skënderbeu” të Haxhiademit do të ndalemi në theksin logjik dhe emocional. Kjo tragjedi u shkrua në Gjirokastër, më 1935 dhe u botua në Tiranë po në këtë vit, nga shtëpia botuese “Luarasi”. Në kulmin e madhështisë së tij, Skënderbeu tradhtohet nga kushëriri dhe gjenerali i tij më i mirë. Moisiu i nxitur nga hakmarrja e së shoqes, Zafinës, që është dhe protagonistja kryesore e tragjedisë, vjen në krye të ushtrisë së sulltanit, për të mundur Skënderbeun. Moisiu mundet dhe falet prej Skënderbeut. Edhe Zafina vret veten, duke dështuar me intrigat e saj hakmarrëse për pushtet kundër Skënderbeut. Kjo tragjedi bashkon elementë të shumtë kulturorë dhe etnikë, të cilët lidhen me atdhetarizmin e shqiptarëve, si kombas të truallit shqiptar. Madhështia e kësaj tragjedie jepet nëpërmjet hapësirës së gjerë të dialogëve midis personazheve.

⁹ *Po aty.*

¹⁰ A. Xhiku, *Nga romantizmi rrjedhave të ralizmit*, Tiranë, 1989, f. 153.

Sepse dialogu dramatik është gjithmonë i menduar dhe i formësuar estetikisht, nuk është bisedë e thjeshtë, por hallkë e folur e zhvillimit të veprimit, e thënieve dhe e kundërthënieve, gjithnjë me intesitet konativ deri në konfrontim me konfliktin tragjik¹¹.

E ndërthur me vargun njëmbëdhjetë rrokësh dhe pesëkëmbshin jambik neoklasicist, ku ndërthuren fryma romantike e simboliste, por edhe realiste e klasiciste, kjo vepër shënjon një ndërtim klasik të ligjërimit¹².

Disiplinat gjuhësore që marrin në shqyrtim tekstin letrar, dhe në veçanti ato drejtime shkencore që shqyrtojnë më nga afër tekstin letrar kanë përvijuar metodologji dhe një aparat konceptual që ndihmon për shqyrtimin më të thelluar të formave diskursive dhe të shumësisë së zërave që shprehen në të¹³.

Theksi hyn në dukuritë prozodike¹⁴, si tonet dhe intonacioni¹⁵. Sipas vendosjes së theksit në fjalë, përcaktohet

¹¹ Gj. Shkurtaç, *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë, 2009, f. 207.

¹² J. Mato, *Poetika e dramaturgjisë dhe mendimit estetik*, Tiranë, 2005, f. 207.

¹³ T. Plangarica, “Shkencat e ligjërimit dhe një variant të lexuarit i këngës së fundit të Milosaos”, në Aktet e konferencës shkencore ndërkombëtare *Letërsia dhe kultura arbëreshe Jeronim De Rada në 200-vjetorin e lindjes*, organizuar nga UE “A. Xhuvani”, Elbasan, 2014. f. 4.

¹⁴ “Prozodia është ajo pjesë e fonetikës ku përfshihet lartësia, intensiteti, gjatësia dhe heshtja, që duke karakterizuar njësi më të mëdha se fonemat na japin theksat, intonacionin, junkturën dhe pauzën”. L. Boriçi, “Intonacioni dhe funksionet e tij në gjuhën shqipe”, në *SF*, nr. 2, Tiranë, 1987, f. 75, shën 2.

¹⁵ Deri nga viti ’60-të intonacionin e gjejmë të përmendur vetëm në tekstet e gramatikës së gjuhës shqipe. Më vonë e gjejmë të trajtuar, për nga ana funksionale, sintaksore, edhe në gramatika të tjera, por duke i atribuar fillimisht vetëm funksionin modal e më pas edhe funksione të tjera, si funksionin ekspresiv e atë shprehës të raporteve sintaksore midis fjalive të një periudhe, duke bërë kështu të dallohen raportet e bashkërenditjes nga ato të nënrenditjes e llojet e tyre. Që nga ajo kohë, interesimi e përpjekjet për ta njohur edhe më mirë natyrën gjenetike –akustike e në veçanti funksionet e intonacionit të shqipes kanë ardhur duke u rritur. *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, III, Tiranë, 1983, f. 29.

kuptimi i fjalës dhe i fjalisë. Dukuritë prozodike shërbejnë për të vënë në dukje gjatë ligjërimin, pohimin, pyetjen, çudinë, habinë, urdhrin etj., pra informacionin që duam të transmetojmë.

Intonacioni luan rolin kryesor nga të gjithë elementet prozodike, megjithatë, ku më shumë e ku më pak ndihmohet edhe nga elemente të tjera prozodike si pauza¹⁶, theksi e junktura¹⁷, nga rendi i fjalëve në fjali si dhe nga shtresa semantike. Elementi me të cilin intonacioni duke se bashkëvepron më fort në shqipe është pauza¹⁸.

Intonacioni nuk përdoret vetëm për të shprehur llojet e ndryshme të kuptimeve emocionale, por shërben si mjet gjuhësor, meqë në saje të tij realizohen nuancat kuptimore të ligjërimin. Roli që intonacioni luan gjatë ligjërimin deri tani ka zënë një vend të kufizuar në literaturën tonë nga ana e gjuhëtarëve.

Gjuha shqipe bën pjesë në grupin e atyre gjuhëve ku theksi në fjalë të ndryshme mund të bjerë në rrokje të ndryshme. Në fjalët e gjuhës shqipe mbizotëron theksi parafundor (fjalë paroksitone). Rregullimi mekanik i theksit me nguljen e tij në rrokjen e parafundit është një proces historik i shqipes¹⁹. Këtë gjë

¹⁶ Me pauzë kuptojmë vetëm ndërprerjen e ligjërimin, heshtjen, ndërsa me pauzën e “zëshme” të hezitimit, e cila manifestohet me tinguj të ndryshëm, e konsiderojmë si element paragjuhësor. L. Boriçi, *vep.cit.*, f. 85.

¹⁷ Junktura konsiderohet nga disa autorë si p.sh. Martineja, si element segmentor ndaj e trajtojnë në fonematikë, ndërsa disa të tjerë si B. Malmberg dhe I. Lehiste, meqë karakterizon njësi më të mëdha se segmenti parapëlqejnë ta fusin ndër elementet prozodike krahas intonacionit, theksit e pauzës. Kështu me juncture Malmbergu kupton kufij rrokjesorë, të cilët realizohen sipas tij, me anë të disa tipareve fonetike “cues” nga të cilët përmend rrëshqitjet formantike të zanoreve. Ndërsa nga ana funksionale ka mendimin, se të gjitha llojet e kundërvëniet theksore e intonative të frazës që kanë kryesisht funksione demarkative mund të konsiderohen pa dyshim si junktura dhe është e logjikshme që tiparet e tyre të intonacionit, forces e gjatësisë të shihen si manifestimet e tyre. Shih L. Boriçi, *vep. cit.*, f. 86, shën 30.

¹⁸ L. Boriçi, *vep. cit.*, f. 85.

¹⁹ E. Çabej, *Studime për fonetikën historike të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1988, f. 15.

e vëren edhe S. Frashëri në gramatikën e tij, kur thotë se “gjuha e do aqë fort të xgjaturitë në rrokjet që është përpara së fundit, sa në të folurë i presim më shumë të zëshmetë që vinë pas saj”²⁰.

Përkufizimi i theksit është i vështirë, pasi nuk i përgjigjet një karakteristike të vetme akustike, por tre parametrave të ndryshëm: gjatësisë, intensitetit dhe lartësisë. Me theks kuptohet shqiptimi i në rrokjeje, i një fjale a i një fjalie me një ton më të fuqishëm, me një intensitet më të madh se rrokjet, fjalët ose fjalitë e tjera të së njëjtës tërësi për ta vënë atë më në dukje.

Dodi e përkufizon theksin si *të spikaturit e një rrokjeje me mjete të ndryshme fonetike*²¹.

Theksi i fjalës nuk është i vetmi lloj i theksit në gjuhën shqipe. Në njësitë më të mëdha se fjala, brenda fjalisë mund të kemi edhe theksa të tjerë që nuk lidhen me fjalën si të tillë, por me njësi më të mëdha se ajo.

Dhe në sistemin e vargëzimit, kundërvënia bazë është sipas gjatësisë së rrokjes, e theksuar /patheksuar. Vargjet shqipe kanë të detyrueshme në mbyllje të vargjeve theksin parafundor si theks ritmik, prandaj në metrikë llojet e vargjeve paraqiten sipas numrit të rrokjeve²².

Sipas Zhejit, studiues i vargëzimit të shqipes në rregullat e ndërtimit të vargjeve sipas sistemit silabotonik vërehet një simetri ritmike, e cila merr parasysh jo vetëm numrin e rrokjeve, por edhe të theksave²³.

Në vargjet silabotonikë haset dhe *cezura*²⁴. Ky element ritmik i vargut ka dy funksione kryesor: ndan metrikisht në dy a

²⁰ S. Frashëri, *Shkronjëtoe e gjuhësë shqip (1886)*, Vepra II, Tiranë, 1988, f. 99.

²¹ A. Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, IGJL, Tiranë, 2004, f. 155.

²² Z. Rrahmani, *Teoria e letërsisë*, Prishtinë, 2008, f. 103.

²³ Gj. Zheji, *Bazat e vargëzimit shqiptar*, Tiranë, 1998, f. 57.

²⁴ Është një pauzë pak a shumë e gjatë brenda vargut, vjen nga lat. caesura < ndarje.

më shumë pjesë vargun, dhe nga ana tjetër vë në dukje pikërisht me anë të pauzës, vargun tjetër. Kjo bie në sy te vargjet e dyzuara, të cilat cezura i dan në dy *hemestikë*²⁵.

Në mjetet e posaçme të intonacionit, d.m.th. të atyre që realizohen në njësi më të mëdha se fjala, në fjali ose togfjalësja, përveç theksit në grupin fonetik bën pjesë edhe theksi i ngulimit ose i insistimit që përdoret për të nxjerrë në pah atë pjesë të frazës që është më i rëndësishëm nga ana kuptimore. Theksi i ngulimit përfshin theksin *logjik* dhe *emocional*²⁶.

Theksi logjik lidhet me përmbajtjen e frazës apo të vargut. Ai vë në pah fjalën që mban peshën kryesore brenda vargut apo frazës. Theksi logjik realizohet me rritje të intensitetit të rrokjes së theksuar të fjalës së spikatur nga ana kuptimore. Studiues të ndryshëm shprehin pikëpamje të ndryshme në lidhje me funksionet e theksit logjik. Dodi shprehet se “theksi logjik nuk jep kuptim krejt të ri, por vetëm nuanca të reja kuptimore”²⁷, ndërsa sipas Boriçit “spikatja me anë të theksit logjik jo vetëm që mund të japë një nuancë të re kuptimore, por mund të ndryshojë tërësisht kuptimin e thënies”²⁸.

Theksi logjik mund të bjerë në çdo fjalë që folësi e quan më të rëndësishme nga kuptimi në situatën e ligjërimit. Megjithatë theksi logjik mund të bjerë edhe në fjalë që normalisht nuk kanë theks, d.m.th. janë atone. Shpesh forcimi i zanores së fjalisë që bart theksin logjik shoqërohet edhe me ndryshimin e intervalit të lartësisë së tonit, d.m.th. zanorja që bart theksin logjik është jo vetëm më e fortë, por shqiptohet edhe me ton më të lartë ose më të ulët²⁹.

²⁵ Gj. Zheji, *vep. cit.*, f. 57.

²⁶ A. Dodi, *vep. cit.*, f. 190.

²⁷ A. Dodi, “Intonacioni në gjuhën shqipe, komponentët dhe funksionet e tij gjuhësore”, në *Gjuha jonë 3-4*, Tiranë, 1999, f. 47.

²⁸ L. Boriçi, “Intonacioni dhe funksionet e tij në gjuhën shqipe”, në *SF*, nr. 2, Tiranë, 1987, f. 82.

²⁹ A. Dodi, *vep. cit.*, f. 191.

Theksi emocional shfaqet në varg apo në frazë për të përforcuar anën emocionale. Ai shfaqet atëherë kur fjala apo fraza merr ngjyrim afektive. Përforcimi i ngarkesës emocionale të fjalëve me anë të theksit emocional bëhet kryesisht me zgjatjen e zanores së theksuar dhe me ngritjen e tonit themelor në zanore. Dallohet më lehtë te pasthirrmat, por edhe te fjalët me ngjyrim të veçantë emocional. Mjetet për realizimin e këtij theksi ndryshojnë në varësi të llojit të emocionit, qoftë ky emocion pozitiv apo negativ.

Ligjërimi jo vetëm aktualizohet në kohë, por është i lidhur ngushtësisht me veprimin dhe situatën e komunikimit. Gjithashtu gjatë ligjërimit përfshihet një sistem i tërë shenjash verbale dhe joberbale, të cilat janë thelbësore gjatë komunikimit. Lëvizjet e qëndrimet e ndryshme, si gjestet, shprehja e fytyrës, shpejtësia e ligjërimit, përkujdesja në shqiptimin e fjalëve etj., u japin njësave gjuhësore interpretime të ndryshme kuptimore. Për të thënë gjëra edhe të thjeshta, duhet që mendimi të bëhet veprim dhe thënia të imponohet nëpërmjet gjuhës, gjithashtu duhet që gjuha të jetë herë depërtuese, therëse, energjike, e lirë, herë vibruese e plot pasion dhe herë e thjeshtë e elastike, madje shpesh dhe hipokrite.

Fjala teatër > lat. *theatrum*, gr. *thèatron* (shoh, vëzhgoj) është një vepër narracioni për spektatorin. Teksti teatror është një histori e krijuar nga autori, gjatë të cilit komunikimi pasurohet me elemente të reja: autori ▶ mesazhi ▶ kanali/kodi, teksti ▶ publiku. Një vepër teatrore është një tërësi gjestesh me zotërim gjuhësor, i paracaktuar për të qenë i pranuar estetikisht në një shfaqje skenike.

*Teatri rrëfëhet, nuk teorizohet, jepet vetëm me teatrin dhe shpjegohet thellësisht në teatër*³⁰.

Teksti dramatik ofron mundësi interpretimi afektiv dhe intelektual. Interpretuesi quhet i talentuar, nëse arrin të nxjerrë nga teksti të gjitha vlerat potenciale të tij, duke e zotëruar lojën e

³⁰ G. Strehler, *Per un teatro umano*, “Feltrinelli”, Milano, 1974, f. 15.

ndryshimit të tonit, e cila në dallim nga biseda e zakonshme është më e pasur. Gjatë një bisede të zakonshme ne nuk e dallojmë lojën e ndryshimit të tonit, pasi jemi të tërhequr nga fjalët, ndërsa në teatër ligjërimi i folur është i papritur. Prandaj gjatë shkollimit të tij, aktori studion që të jetë sa më origjinal në shprehjen e ndjenjave, si zemërim, habi, urrejtje etj., nëpërmjet ndryshimit të tonit, por gjithashtu duhet të ketë si talent edhe zërin, për t'iu përshtatur sa më lehtë karaktereve të ndryshme të tekstit dramatik.

Po ilustrojmë theksin logjik dhe theksin emocional në disa vargje të shkëputura nga tragjedia “Skënderbeu”³¹ me pesë akte të Haxhiademit:

*O ti shkëndi*³² e vetme dhe me vlerë
E princit qi ndrroi jet´ si kallogjerë
 Gëzohem qi e paç kët´fat të bardhë
Ty të takoj, mbassi për **ty** kam ardhë.
 Vetëm me **ty çmallohem** prej vetiut:
N´fytyrën tande shoh të Moisiut.

O princ, un ditëzeza ktu në Krujë.
Për muë nashti kan´perënduë lumnitë;
Mallkuë qoftë ora qi më nxuërr në dritë!³³

Ky asht një çast i rrallë!
Princesh´, të shihja kam pas´tepër mallë,
 Por shkuen kaq ditë dhe **ti** na humbe fare.

³¹ E. Haxhiademi, *Skënderbeu*, “Luarasi”, Tiranë, 1935.

³² Fjalët e pjerrëta tregojnë theksin emocional, ndërsa fjalët me ngjyrë të zezë tregojnë theksin logjik.

³³ E. Haxhiademi, *vep. cit.*, f. 5.

I vorfni, o mbretesh? Oh, sa zili³⁴

Bisedën e mëparshme dëshiroj,
O kont, edhe mâ tepër t’ a vijoj.³⁵

Kush asht **ay i marrë**, o kont, qi flet³⁶

O mbret **ndër lufta** i tërbuëm për gjaqe³⁷

B. Merxhani e ka vlerësuar tragjedinë “Skënderbeu” si ndër më të bukurat kur shprehet: *Fytyra e çuditshme e patosit tonë legjendar, simbolizon tipin e gjeniut tragjik, të cilit nuk i mungon elementi demoniak për të rymëzuar tragjedinë ma të goditur, jo vetëm të jetë së tij private, por edhe të mjerimeve historike të gjithë jetës së popullit shqiptar. Vepra e Haxhiademit asht prova e parë guximtare për të krijuar një tipologji të shpirtit rreth epokë karakteristike të Skënderbeut*³⁸.

Përmes tragjedive të tij Haxhiademi synoi të krijojë realitete artistike, të cilat do të ishin të përvetësueshme estetikisht prej lexuesit dhe përmes këtij përvetësimi estetik, ato do të bëheshin më dinjitozë në marrëdhëniet me njëri-tjetrin, me kombin, me shtetin, me traditën e tyre, me moralin që trashëgojnë dhe kultivojnë për të ardhmen. Me këto synime ai arriti përmes nivelit cilësor të krijimtarisë së tij, si asnjë tjetër në dramatikën shqiptare³⁹.

³⁴ E. Haxhiademi, *vep. cit.*, f. 12, 13.

³⁵ *Po aty*, f. 23.

³⁶ *Po aty*, f. 58.

³⁷ *Po aty*, f. 68.

³⁸ B. Merxhani, “Rreth tragjedisë Skënderbeu. Një polemikë letrare”, Tiranë, 1937, *Përpyjekja shqiptare*, nr. 8, f. 121-126.

³⁹ T. Plangarica, *vep. cit.*, f. 159.

BIBLIOGRAFI

- Boriçi, L., “Intonacioni dhe funksionet e tij në gjuhën shqipe”, në *Studime filologjike*, nr. 2, Tiranë, 1987, f. 75-87.
- Dodi, A., “Intonacioni në gjuhën shqipe, komponentët dhe funksionet e tij gjuhësore”, në *Gjuha jonë 3-4*, Tiranë, 1999, f. 40-51.
- Dodi, A., *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, IGJL, Tiranë, 2004.
- Çabej, E., *Studime për fonetikën historike të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1988.
- Haxhiademi, E., *Skëndërbeu*, “Luarasi”, Tiranë, 1935.
- Jefferson, A., Robey, D. *Teoria letrare modern. Një paraqitje krahasuese*, Tiranë, 2004.
- Frashëri, S., “Shkronjëto e gjuhësë shqip (1886)”, *Vepra II*, Tiranë, 1988.
- Kroçe, B., *Estetika si shkencë e shprehjes dhe e gjuhësisë së përgjithshme*, Tiranë, 1998.
- Mato, J., *Poetika e dramaturgjisë dhe mendimit estetik*, Tiranë, 2005.
- Merxhani, B., “Rreth tragjedisë Skëndërbeu. Një polemikë letrare”, Tiranë, 1937, *Përpyekja shqiptare*, nr. 8, f. 121-126.
- Plangarica, T., *Tekst, për tekstin*, Elbasan, 2002
- Plangarica, T., “Shkencat e ligjërimit dhe një variant të lexuarit i këngës së fundit të Milosaos”, në Aktet e konferencës shkencore ndërkombëtare *Letërsia dhe kultura arbëreshe Jeronim De Rada në 200-vjetorin e lindjes*, organizuar nga UE “A. Xhuvani”, Elbasan, 2014.

- Plangarica, T., “Variant leximi i poezisë “Kristal” të I. Kadaresë”, botuar në përmbledhjen me studime *Kadare, leximi dhe interpretimi*, Onufri, 2016.
- Plangarica, T., “Jo vetëm dramaturgu, por edhe poeti”, në *Vlera të rishfaqura*, Tiranë, 2019.
- Rrahmani, Z. *Teoria e letërsisë*, Prishtinë, 2008.
- Sinanaj, V., *Ndikimi ndërgjuhësor në kontaktin midis dy gjuhëve. Rasti i shqipes me italishten*, ASA, IGJL, Tiranë, 2020.
- Strehler, G., *Per un teatro umano*, Milano, 1974.
- Rrokaj, Sh., *Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*, Tiranë, 2012
- Shkurtaç, Gj., *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë, 2009.
- Xhiku, A., *Nga romantizmi rrjedhave të realizmit*, Tiranë, 1989.
- Xhiku, A., *Letërsia shqipe si polifoni*, Tiranë, 2004.
- Zheji, Gj., *Bazat e vargëzimit shqiptar*, Tiranë, 1998.

